Projekti “Certifikoni italishten tuaj. Gjuha për t’u përfshirë në shoqëri, për punën dhe nënshtetësinë”

Viti mësimor 2011/12

Shkolla italiane

Tekste prezantimi në ppt

Slide 1

TË STUDIOSH NË ITALI

Slide 2

SHKOLLA PËR MUA

Në Itali ekzistojnë kurse arsimimi dhe trajnimi edhe për të rriturit

Ku?

- në CTP-të (Qendrat Territoriale të Përhershme) që bëjnë pjesë në sistemin e arsimit kombëtar
- në Shkollat e Mesme të natës
- në Shkollat e Formimit Profesional

Slide 3

QENDRAT TERRITORIALE TË PËRHERSHME

CTP-të janë të shumta dhe nuk është e vështirë për t'i gjetur

Çfarë ofrojnë?

- kurse falas të italishtes për të huaj me mundësi certifikimi
- kurse falas për certifikatën e nivelit të mesëm
- kurse anglishteje dhe kompjuteri

Kujdes

Në CTP-të kryhen testet për njohjen e gjuhës italiane për shtetasit e huaj që kërkojnë lejen e qëndrimit të KE-së (ish- karta e soxhornos)

Slide 4

PËR TË VAZHDUAR STUDIMIN PAS CERTIFIKATËS SË NIVELIT TË MESËM...

- ekzistojnë shkollat e mesme të natës

Çfarë ofrojnë?

- një arsimim të lartë teknik (kontabilitet, gjeometër, ekspert informatike etj.), profesional ose tjetër ...
- mundësi studimi më të shkurtër (3-4 vjet)
- diplomë e përfundimit të shkollës së mesme (pjekurisë)

Slide 5

TRAJNIMI PËR PUNËN PAS CERTIFIKATËS SË NIVELIT TË MESËM

Shkolla e Formimit Profesional

Çfarë ofron?

- Mundësinë e mësimit të një zanati në kurse që zgjasin 1 deri 3 vjet

Slide 6

KAM NJË TITULL STUDIMI NË VENDIN TIM TË ORIGJINËS, A ËSHTË I VLEFSHËM EDHE NË ITALI?

- Titulli i studimit është i vlefshëm vetëm nëse është lëshuar nga një vend i Bashkimit Evropian, ose një vend që ka marrëveshje reciproke njohjeje të diplomave

NËSE NUK ËSHTË I VLEFSHËM, ÇFARË MUND TË BËJ?

- Në këtë rast është e mundur të merret njohja e titullit të studimit

Slide 7

PËR NJOHJEN E TITUJVE TË STUDIMIT

- shkoni në Konsullatën Italiane dhe bëni ekuivalentimin

- ose bëni një përkthim të nënshkruar të titullit të studimit pranë një gjykate italiane (deklaratë nën betim)

Kujdes

Në disa raste është e nevojshme të kesh një titull italian studimi.
Për informacione të tjera (certifikatë e nivelit të mesëm, kurse ASA, shkollë e mesme e natës, kurse të italishtes …) pyesni pranë CTP-së më të afërt

Slide 8

SHKOLLA PËR FËMIJËT E MI

Çfarë duhet të bëj për arsimimin e fëmijëve të mi?

- Është e nevojshme të dini si funksionon shkolla italiane

Kujdes

Shkolla italiane pranon **gjithmonë** regjistrimin e një fëmije, një të riu nën 18 vjeç, edhe nëse vjen gjatë një viti shkollor që ka filluar

Slide 9

ARSIMIMI NË ITALI

Si funksionon shkolla në Itali?

- Shkolla është e detyruar nga mosha 6 deri 16 vjeçare

  - Çerdhja: nga 0 deri 3 vjeç
  - Parashkollori: nga 3 deri 6 vjeç
  - Shkolla fillore nga 6 deri 11 vjeç
  - Shkolla 8-vjeçare nga 11 deri 14 vjeç
  - Shkolla e mesme nga 14 deri 19 vjeç

Slide 10

ARSIMI I DETYRUAR

Arsimi i detyruar zgjat 10 vjet

- 5 vjet të shkollës fillore
- 3 vjet të shkollës 8-vjeçare
- 2 vjet të shkollës së mesme ose shkollës së formimit profesional (trevjeçare me kualifikim)

Në shkollën fillore librat janë FALAS, familjet duhet të blejnë vetëm fletoret, stilolapsat dhe lapsat me ngjyra….

Slide 11

ARSIMI PËR TË RINJTË

Për të rinjtë e moshës 16/18 vjeç formimi është i detyruar
Ku mund të shkohet për të kryer formimin e detyruar?

- në CTP-të nëse nuk kanë certifikatë të nivelit të mesëm
- në shkollat e mesme
- në Shkollat e Formimit Profesional
- në Qendrat e praktikës

Slide 12

REGJISTRIMI I FËMIJËVE NË SHKOLLË

Çfarë duhet të bëj për regjistrimin e fëmijëve të mi në shkollë?

- shkoni pranë sekretarisë së shkollës më të afërt (vedi link)
- tërhiqni formularin e regjistrimit me listën e dokumenteve të nevojshme

Slide 13

DOKUMENTET PËR REGJISTRIMIN

Cilat janë dokumentet që duhet të sjell?

- certifikata e lindjes
- certifikata e vaksinimit
- dokumentet e shkollës së frekuentuar në vendin e origjinës ose **një deklaratë** për klasën e frekuentuar në vendin e origjinës
- faturën e pagesës së taksave shkollore në Itali

Slide 14

FORMULARËT E REGJISTRIMIT ...

Çfarë tjetër duhet të bëj në momentin e regjistrimit?

- të plotësoni formularin për pranimin ose refuzimin e mësimit të fesë katolike
- të plotësoni formularët për të kërkuar:
  * mensën shkollore
  * shkollën para orarit (të shkojë në shkollë më herët) dhe/ose shkollën pas orarit (të dalë më vonë)
  * transportin shkollor

- të tërhiqni librezën shkollore për të justifikuar mungesat në shkollë, vonesat dhe daljet përpara orarit

Kujdes
Shkolla para orarit, shkolla pas orarit, mensa dhe transporti janë shërbime me pagesë

Slide 15

RREGULLAT EDUKATIVE

Disa rregulla edukative të shkollës italiane ...

- djemtë dhe vajzat qëndrojnë së bashku në të njëjtën klasë
- studiojnë, luajnë dhe ushtrojnë sportet së bashku
- askush nuk mund të rrahë një fëmijë si ndëshkim
- të gjithë duhet të respektojnë Kartën e të Drejtave të Fëmijëve

Slide 16

FAMILJA DHE ARSIMI SHKOLLOR

Në Itali, prindërit janë të detyruar t'i arsimojnë fëmijët e tyre
Çfarë mund të bëjë një familje nëse ka vështirësi për të paguar studimet?

Mund të njoftojë sekretarinë e shkollës ose Shërbimet Sociale të Komunës për të ditur se çfarë ndihmash mund të përfitojë.

Për shembull ekzistojnë:
* ulje çmimesh për shërbimet e mensës, transportin, shkollën para orarit …

* ndihmë financiare shkollore për nxënësit që vazhdojnë studimet dhe formimin
* bursa studimi për nxënësit më të mirë

Kujdes
Prindërit e huaj humbin lejen e qëndrimit
nëse nuk i dërgojnë fëmijët e vegjël në shkollë

Slide 17

FJALORTH

Shkollim i detyruar: deri në 16 vjeç vajtja në shkollë është e detyruar

Formimi i detyruar: nga 16 deri 18 vjeç është i detyruar vazhdimi i formimit. Nëse një i ri nuk shkon në shkollë duhet të vazhdojë si praktikant ose të vazhdojë shkollën e formimit deri në moshën 18 vjeçare

Libreza shkollore: shërben për të justifikuar mungesat e fëmijëve. Kur mungesa zgjat më shumë se 5 ditë për arsye shëndetësore, është i nevojshëm raporti mjekësor nga mjeku; libreza nevojitet edhe për të autorizuar vonesat ose daljet përpara orarit

Slide 18

FJALORTH

Zyra e sekretarisë: çdo shkollë ka një zyrë sekretarie ku mund të kërkohet informacion, të dorëzohen dhe të merren dokumente. Zyra nuk është gjithmonë e hapur, informohuni paraprakisht mbi ditët dhe oraret e hapjes.

Ndihma financiare shkollore: është një kontribut rajonal që ndihmon familjet në shpenzimet për shkollën, për periudhën e arsimimit të nxënësve nga 6 deri në 18 vjeç. Për informacione të mëtejshme pyesni pranë Komunës.

Ora e fesë: çdo vit, kur prindi regjistron fëmijën në shkollë, duhet të deklarojë nëse pranon ose jo mësimin e fesë katolike.